



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:064372
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762378

PPP.nr.36/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A.H. nga fsh ..., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson av Ramadan Sylejmani nga Ferizaj, kundër debitorit CO M. L.L.C, me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Jeton Berisha nga Ferizaj, për përmbartimin e aktgjykimit C.nr.690/16, të datës 24.03.2021, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, me datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit CO M. L.L.C, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.130/2024, të datës 12.02.2024, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.130/2024, i datës 12.02.2024.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbartim P.nr.130/2024, të datës 12.02.2024, Përmbartuesi privat B.A.e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit A.H., kundër debitorit CO M. L.L.C, për përmbartimin e aktgjykimit C.nr.690/16, të datës 06.04.2021, për pagesën e borxhit në shumë prej 4,826 euro dhe kamëtën ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit C.nr.690/16, të datës 06.04.2021, (e cila do të aplikohet në shumën e mjeteve prej 38,366 euro, e cila shumë e mjeteve është e paguar nga debitori), si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat B.A., me numër P.nr.130/2024, i datës 12.02.2024, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim se debitori me datën 09.11.2023 ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër aktgjykimit Ac.nr.6235/2021, të datës 22.09.2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës për të cilin revizion akoma nuk është shqyrtuar dhe përmbarimi eventual i shumës së kërkuar para se çështja të shqyrtohet nga Gjykata Supreme, mund t'i shkaktoj dëme të konsiderueshme debitorit në rast të anulimit eventual, në rast se gjykata do të lejonte përmbarimin sipas urdhrin P.nr.130/24, në këtë moment atëherë do ta vështirësonte apo pamundësonte debitorin që në procedurë të kundër përmbarimit ta rikthej shumën e marrë nga ana e kreditorit, gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse fakti që debitori ka ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik siç është revizioni kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me numër AC.nr.6235/2021, të datës 22.09.2023, nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit C.nr.690/16, të datës 06.04.2021, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Për më tepër, në nenin 213, të Ligjit për Procedurën Kontestimore është paraparë : *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*. Po ashtu, gjykata me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin nuk mund ta paragjykoj vendosjen sipas revizionit të debitorit të ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjegjësisht Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, sepse në këtë rast por edhe në rastet e tjera gjykata ka për detyrë vetëm të bëjë zbatimin e dispozitave ligjore gjegjëse të LPP-së dhe LPK-së, që kanë të bëjnë me vendosjen sipas prapësimin të debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim në këtë rast.

Gjithashtu, Gjykata konstaton se përmbaruesi privat B.A., me rastin e nxjerrjes së urdhrit për përmbarim P.nr.130/2024, të datës 12.02.2024, është bazuar në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, sepse në dispozitën ligjore të cekur më lartë është përcaktuar shprehimisht se si dokument përmbarues në bazë të cilit organi përmbarues e cakton përmbarimin konsiderohet edhe aktgjykimi i lëshuar nga gjykata, siç është në rastin konkret aktgjykimi C.nr.690/16, të datës 06.04.2021, i cili e përmban klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri, e paraparë në nenin 36, par 1, të LPP-së, respektivisht aktgjykimi në fjalë është i plotfuqishëm nga data 22.09.2023 dhe i ekzekutueshmen nga data 26.01.2024.

Gjykata, po ashtu konstaton se i autorizuari i kreditorit bashkë me propozimin për përmbarim, tek përmbaruesi privat e ka dorëzuar edhe aktgjykimin C.nr.690/16, të datës 06.04.2021, në origjinal të tij dhe kështu në këtë rast nga i autorizuari i kreditorit janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 36, par 1, të LPP-së.

Përveç tjerash, gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit, siç është afati prej 15 ditësh, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të autorizuarit të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.130/2024, i datës 12.02.2024, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.36/24, më datë 30.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.